



Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës dhe në bazë të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor Nr. 02/L-52:

Kopshti "BOTANIKA"

SHPALL KONKURS PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE PËR VITIN KALENDARIK 2015/2016

Nr	Grup-mosha	Numri i fëmijëve
1.	0.9 muaj - 2 vjeç	12 fëmijë
2.	2-3 vjeç	18 fëmijë
3.	3-4 vjeç	20 fëmijë
4.	4-5 vjeç	15 fëmijë
5.	5-6 vjeç	15 fëmijë
TOTALI		80 fëmijë

Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

1. Ekstrakti i lindjes për fëmijën;
2. Dëshmia që jeni banorë të lagjes Mati I apo II (vërtetimi nga Bashkësia Lokale; fatura të shërbimeve, dëshmi apo kontratë të pronës/vendbanimit etj)
3. Kontrata e punës për të dy prindërit (nëse punojnë të dy);
4. Gjendja e llogarisë bankare për të dy prindërit, për tre muajt e fundit;
5. Vërtetimi i kontributit nga Trusti Pensional për të dy prindërit (nëse punojnë të dy);
5. Dokumentet tjera valide të lëshuara nga institucionet relevante për të dëshmuar kategoritë tjera.

Çmimi i çerdhës është 100 euro në muaj.

Por në bazë të të ardhurave mujore që marrin të dy prindërit, Komuna e Prishtinës do të subvencionon një pjesë të pagesës:

1. Prindërit me të ardhura mujore deri në 500 euro, Komuna i subvencionon me vlerë 50 euro në muaj për fëmijë.
2. Prindërit me të ardhura mujore deri në 700 euro, Komuna i subvencionon me vlerë 30 euro në muaj për fëmijë.
3. Prindërit me të ardhura mujore deri në 1000 euro, Komuna i subvencionon me vlerë 20 euro në muaj për fëmijë.
4. Prindërit me të ardhura mujore mbi 1000 euro nuk do subvencionohen nga Komuna dhe paguajnë pagesën e plotë

Pranimi i dokumenteve bëhet prej datës **29 korrik 2015** deri më **10 gusht 2015**. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në kopshtin “Botanika” çdo ditë pune prej orës **10:00** deri në ora **16:00**. Shpallja e rezultateve bëhet më **14 gusht 2015** në kopshtin “Botanika”.

Regjistrimi i fëmijëve bëhet bazuar në rregullën ai që vjen i pari vjen pranohet i pari.

Të gjithë të pakënaqurit me rezultatet e regjistrimit mund të ushtrojnë ankesë në kopshtin “Botanika”, **Rr: Isa Kastrati; Mati II, Prishtinë**

Vërejtje: Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë që dorëzohen do të verifikohen nga institucionet përkatëse dhe nëse ka dyshime mbi vërtetësinë e dokumentacionit apo dëshmive do të humbni të drejtën për subvencionim të pagesës.